



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Tiranë, më 14.12.2017

NJOFTIM

“PËR NGRITJEN NË DETYRË NË KLSH”

Në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 152/2013, datë 01.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”, si dhe Vendimin nr. 4, datë 27.01.2017 të Kryetarit të KLSH “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar;

Ju njoftojmë se:

Kanë filluar procedurat për ngritje në detyrë përkatësisht për:

I. Për pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Logjistikës.

Në konkurrim ftohen të marrin pjesë audituesit dhe punonjësit që plotësojnë këto kriteret:

- të kenë eksperiencë pune në KLSH mbi 4 vjet
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë vlerësime pozitive në punë;
- Do favorizohen punonjësit që kane statusin e ish-të përndjekurit politik

Të gjithë të interesuarit duket të paraqesin kërkesën e tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore deri më datë 16 Dhjetor 2017.

Testimi për ngritje në detyrë do të zhvillohet bazuar në rezultatet e punës, nga vlerësimi i dosjes individuale dhe intervista e strukturuar me gojë nga Komiteti i Pranimi Për Ngritjen në Detyrë.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE